



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 15220 Prot.

Lezhë, më 12.09.2022

URDHËR

Nr. 500 ., datë 12 / 09 /2022

“PËR  
KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR  
DIASPORËN DHE MIGRACIONIN NË BASHKINË LEZHË”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimi Nr. 393., datë 18.07.2022 Për “Miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë, ”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e grupit të punës për hartimin e strategjisë për diasporën dhe migracionin në Bashkinë Lezhë, si më poshtë:
  - **Eueda Molla** – Kryetar, me detyrë Zv. Kryetar në Bashkinë Lezhë;
  - **Elson Frroku** – Koordinator, me detyrë drejtor në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës;
  - **Marte Fetaj** – Anëtar, me detyrë drejtor në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social;
  - **Denis Frroku** - Anëtar, me detyrë drejtor në Drejtorinë Juridike;
  - **Jetmira Leka** – Anëtar, me detyrë drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;
  - **Nikolin Shtjefni** – Anëtar, me detyrë drejtor në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit;
  - **Dritan Boçi** - Anëtar, me detyrë drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;

2. Grupi i punës ka për detyrë hartimin strategjisë për Diasporën, Migracionin. Për këtë qëllim, grupi i punës të organizojë punën në këto drejtime:
  - Të analizojë kontekstin historik, faktit dhe ligjor për çështjet e diasporës.
  - Të identifikojë nevojat e diasporës dhe prioritetet qeverisëse.
  - Të hartojë një plan për konceptimin e nje projekti paraprak të prioriteteve kryesore.
  - Të hartojë planin e veprimit si pjesë përbërëse e strategjisë.
3. Koordinator i grupit do të koordinojë informacionin brenda grupit të punës dhe të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen të ofrojnë informacionin dhe ekspertizën e tyre sipas fushave që mbulojnë.
4. Grupi i punës duhet të dalë me një material për të filluar procedurën për hartimin e strategjisë brenda 30 ditë pune.
5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet grupi i punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**

